



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
OSNOVNI SUD U PRIZRENU – BASIC COURT OF PRIZREN

AD-GJTHPZ.nr.18/23

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Kryetarja e gjykatës Shpresa Emra, duke vepruar sipas kërkesës për inicim të procedurës disiplinore të parashtruar nga ana e ankuesit Xh.C., nga Prizreni, ndaj gjyqtarit Sh.H., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren, Departamentin e Përgjithshëm-Divizioni Civil, lidhur me veprimet dhe sjelljen e gjyqtarit sipas lëndës C.nr.1766/2020, në bazë të së cilës është bërë inicimi i procedurës disiplinore, me dt.29.11.2023 mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e ankuesit Xh.C., nga Prizreni, ndaj Gjyqtarit Sh.H., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren, Departamentin e Përgjithshëm - Divizioni Civil, lidhur me veprimet dhe sjelljen e gjyqtarit sipas lëndës C.nr. 1766/2020.

A r s y e t i m

Parashtruesi i ankesës Xh.C., nga Prizreni, ka parashtruar Kërkesë për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit Sh.H., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren, Departamentin e Përgjithshëm – Divizioni Civil, lidhur me veprimet dhe sjelljen e gjyqtarit sipas lëndës C.nr. 1766/2020.

Ankuesi Xh.C., në Propozim ka cekur se ai në lëndën civile C.nr. 1766/20 është në cilësi të palës së paditur dhe se gjyqtari i çështjes Sh.H., ka shkelur etikën profesionale të gjyqtarit duke shkelur të drejtat e njeriut respektivisht të drejtën e komunitetit dhe i ka tejkaluar kompetencat e veta duke vepruar në mënyrë arbitrare në lëndën e lartcekur. Gjithashtu sipas ankuesit gjyqtari duke shfrytëzuar autoritetin e tij në mënyrë joligjore ka shkelur parimin e gjykimit në kohë të arsyeshme duke e zvarritur procedurën dhe duke shtyrë shqyrtimet edhe pse lënda është që nga viti 2020. Ankuesi pretendon se gjyqtari ka pasur sjellje raciste për shkak se i njëjti është i nacionalitetit Rom dhe për këtë arsye ka prolonguar çështjen duke e shtyre pa kurrfarë arsye. Gjithashtu edhe në seanca të mbajtura nuk i ka dhënë fjalën e të paditurit këtu ankuesit duke e paralajmëruar se do ta largojë nga salla e gjykimit. Ankuesi ka cekur sa ka tentuar të bisedojë me gjyqtarin në lidhje me çështjen jashtë shqyrtimit, por i njëjti nuk ka pranuar edhe pse ka qenë i lirë dhe nuk ka pasur seancë. Në bazë të gjitha këtyre pretendimeve ankuesi kërkon që gjyqtari të përjashtohet nga kjo lëndë dhe ndaj tij të merren masa adekuate ligjore disiplinore.

Gjyqtari në deklaratën e tij lidhur me pretendimet e ankuesit ka cekur se është e vërtetë që ankuesi e ka cilësinë e palës së paditur në çështjen civile për ndarjen e pasurisë së përbashkët me ish bashkëshorten e tij L.K., përveç ankuesit si të paditur janë edhe prindërit e tij R.C., dhe S.C.,. Këtë lëndë gjyqtari e ka trashëguar nga gjyqtari paraprak dhe e ka pranuar në muajin shtator të vitit 2022. Pas pranimit të lëndës me dt. 29.09.2022 nga ana e palës paditëse është parashtruar Propozimi për caktimin e masës së sigurisë. Pas kësaj është mbajtur seanca dëgjimore ku është

aprovuar masa e sigurisë . Ndaj Aktvendimit për caktimin e masës së sigurisë nuk ka pasur ankesë dhe është caktuar seanca përgatitore të cilën me parashtresë e autorizuar e paditëses ka kërkuar që të shtyhet pasi që në ndërkohë ka revokuar autorizimin ndaj njërit avokat dhe nuk ka pasur avokat tjetër. Në ndërkohë pala paditëse ka angazhuar një avokate tjetër e cila gjithashtu ka kërkuar shterjen e seancës së caktuar nga ana e gjyqtarit me dt. 27.04.2023 për shkaqe të arsyeshme të cilën kërkesë e ka aprovuar gjyqtari. Seanca e radhës është mbajtur dhe janë propozuar prova të reja dhe me qëllim të sigurimit të këtyre provave është ndërprerë seanca deri në sigurim . Pas kësaj shqyrtimi i radhës është caktuar pas pushimeve verore , por për shkak një trajnimi të gjyqtarit nuk është mbajtur dhe është caktuar data 3 dhjetor 2023.

Gjyqtari sa i përket pretendimeve për sjellje raciste të tij ndaj të paditurit ka cekur se ai nuk ka pasur fare dijeni se i padituri i takon këtij komuniteti, sepse në shkresa të lëndës nuk figuron ky informacion , por gjithsesi kjo nuk do të ndikonte dhe nuk do të ishte arsye për diskriminim sepse ai i trajton dhe i ka trajtuar të gjithë palët në procedurë në mënyrë të barabartë dhe pa dallime. Lidhur me pretendimet se ka qenë i ashpër dhe arbitrar gjyqtari ka deklaruar se pala e paditur edhe pse ka pasur avokat ka komunikuar me ton të lartë dhe ka pasur sjellje arrogante ndaj palës paditëse si dhe ndaj gjykatës dhe ka prishur rendin dhe qetësinë , ku edhe i është tërhequr vërejtja për këtë. Sa i përket pretendimit se nuk e ka pranuar në bisedë është e vërtetë se gjyqtari nuk pranon takim me palën ex parte edhe pse ai ka tentuar të realizohet ky takim. Bazë të gjitha këtyre gjyqtari konsideron se nuk ka vepruar në asnjë mënyrë në mënyrë diskriminuese dhe arbitrare por se veprimet e tija janë të bazuar në ligji dhe në pajtim me dispozitat përkatëse që kanë të bëjnë me palët në procedurë.

Autoriteti kompetent - Kryetarja e gjykatës pasi që ka pranuar Ankesë ndaj gjyqtarit Sh.H., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren, Departamentin e Përgjithshëm - Divizioni Civil, lidhur me lëndën civile C.nr. 1766/2020, ka iniciuar hetimet preliminare për procedurë disiplinore dhe ka ndërmarrë disa veprime në këtë drejtim. Fillimisht ka bërë shikimin në ankesën e parashtruar, ka kërkuar deklaratë nga Gjyqtari i çështjes Sh.H., ka bërë verifikimin e shkresave të lëndës C.nr.1766/2020. Pas vlerësimit dhe analizës së tërësishme të provave të mbledhura Autoriteti Kompetent konsideron se:

Ankesa është e pabazuar.

Autoriteti kompetent - Kryetarja pas verifikimit të gjithë dokumentacionit ka vërtetuar gjendjen faktike si Vijon:

Ankuesi Xh.C., është në cilësi të palës së paditur së bashku me R.C., dhe S.C., ku si paditëse është L.K., ish bashkëshortja e ankuesit , çështja e kontestit është ndarja e pasurisë së përbashkët të pasurisë .Të gjithë palët në procedurë kanë avokat të tyre me autorizim. Lënda i është ndarë Gjyqtarit Sh.H., Pasi që gjyqtari e ka pranuar lëndën nga gjyqtari paraprak është parashtruar edhe Propozimi për caktimin e masës së sigurisë për ndalim të ndryshimit të statusit dhe shitjes së pasurisë së evidentuar në emër të paditurve të cilën kërkesë e ka shqyrtuar dhe e aprovuar gjyqtari me prioritet. Me shikimin në shkresa të lëndës dhe procesverbalet është konstatuar se janë caktuar disa shqyrtime Gjyqësore , ku disa janë shtyrë për shkaqe të arsyeshme (për shkak te ndryshimit të avokatit të palës paditës, për shkak të kërkesës së avokates së paditësve, për shkak te propozimeve te reja të provave). Gjithashtu me shikimin ne shkresa te lëndës dhe procesverbalet e seancave te mbajtura është konstatuar se nuk ka të evidentuar ndonje veprim diskriminues nga ana e gjyqtarit si dhe nga vet ankesa e te paditurit nuk ka ndonjë veprim konkret diskriminues. Veprimet e gjyqtarit per mbajtje te rendit të gjykatës si dhe mospranimi i palës për bisede ex parte

janë veprime të rregullta dhe të parapara sipas LPK-së. Gjyqtari është i obliguar që të mban rendin dhe qetësinë në gjykatë si dhe nuk është e lejuar komunikimi ex parte me palët (vetëm me një palë)

Andaj si Autoritet Kompetent bazuar në të lartë cekura konsideron se gjyqtari Sh.H., në veprimet e tija nuk ka pasur shkelje të cilat konsistojnë me shkeljet disiplinore të parapara me nenin 5 par. 1 nënpar.1.3 dhe nenin 5 par.2 nënpar.2.2 të Ligjit për Përgjegjësinë disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve ku është paraparë trajtimi me ligj i palëve në procedurë gjate ushtrimit të detyrës së saj zyrtare si gjyqtare.

Për arsyet që u cekura me lartë, Autoriteti Kompetent — Kryetarja e Gjykatës ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit në kuptim të nenit 9 paragrafi 6 lidhur me nenin 17 paragrafi 5 të Ligjit nr.06/L-057 për përgjegjësinë disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

AD-GJTHPZ.nr.18/2023

Datë 29.11.2023



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, nuk është e paraparë e drejta e ankesës.